



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 1 korrik 2024
Nr. ref.:RK 2457/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastet nr. KI237/23 dhe KI269/23

Parashtrues

Ilir Mulhaxha

Në rastin KI237/23, vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit [nr. 54/2023] të Ministrisë së Drejtësisë, të 28 shkurtit 2023 dhe vendimit [DPL. nr. 01/2023] të Komisionit Disiplinor për Përmbaruesit Privat, të 23 shkurtit 2023

Në rastin KI269/23, vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit [ARJ 112/2023] të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 17 gushtit 2023

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ilir Mulhaxha nga Peja (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga Yll Zekaj dhe Jeton Hasani, avokatë nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) parashtroi dy kërkesa, dhe atë kërkesën KI237/23 dhe kërkesën KI269/23.
3. Në kërkesën KI237/23, parashtruesi i kërkesës konteston vendimin [nr. 54/2023] e Ministrisë së Drejtësisë, të 28 shkurtit 2023, dhe vendimin [DPL. nr. 01/2023] e Komisionit Disiplinor për Përmbaruesit Privat, të 23 shkurtit 2023.
4. Në kërkesën KI 269/23, parashtruesi i kërkesës konteston aktvendimin [ARJ 112/2023] e Gjykatës Supreme të 17 gushtit 2023, në lidhje me aktvendimin [AA nr. 240/2023], e Gjykatës së Apelit të 24 prillit 2023 dhe aktvendimin [A. nr. 586/2023] e Gjykatës Themelore të 24 marsit 2023.

Objekti i çështjes

5. Objekt i çështjes në kërkesën KI237/23 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat, pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
6. Objekt i çështjes në kërkesën KI269/23 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta, me të cilat, pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
7. Parashtruesi i kërkesës në të dy kërkesat kërkon gjithashtu vendosjen e masës së përkohshme, duke theksuar: *“I kërkojmë Gjykatës të miratojë masën e përkohshme, ashtu që të pezullojë me veprim të menjëhershëm efektet juridike të Vendimeve të kontestuara (DPL. nr. 01/2023 të Komisionit Disiplinor dhe nr. 54/2023 të Ministrisë së Drejtësisë) deri në vendimin final të Gjykatës“.*

Baza juridike

8. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113. [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullat 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) 45

(Vendimmarrja lidhur me kërkesën për masë të përkohshme) dhe 32 (Bashkimi dhe ndarja e kërkesave) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

9. Më 25 tetor 2023, përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës e dorëzuan kërkesën e parë në Gjykatë, të cilën Gjykata e regjistroi me numrin KI237/23.
10. Më 30 tetor 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [GJR.KI237/23], caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
11. Më 7 nëntor 2023, Gjykata njoftoi përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga të njëjtit të dorëzojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme në Gjykatë. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.
12. Më 23 nëntor 2023, përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës e dorëzuan Aktgjykimin e Gjykatës Supreme në Gjykatë.
13. Më 6 dhjetor 2023, përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës parashtruan kërkesën e dytë në Gjykatë, me të cilën kërkuan që Gjykata ta injorojë kërkesën e parë të parashtruar KI 237/23 dhe ta marrë në shqyrtim kërkesën e re të sapo dorëzuar. Gjykata e regjistroi kërkesën e dytë me numrin KI269/23
14. Më 20 dhjetor 2023, Kryetarja e Gjykatës me urdhrin [Urdh. KI237/23, KI269/23], urdhëroi bashkimin e kërkesës KI269/23, me kërkesën KI237/23, ndërsa gjyqtari raportues dhe përbërja e trupit gjykues mbetën të njëjtë si në kërkesën e parë të regjistruar me numrin KI 237/23. Gjykata gjithashtu njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe vendimin për bashkimin e kërkesës KI269/23 me kërkesën KI237/23.
15. Më 16 janar 2024, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, si dhe për vendimin për bashkimin e kërkesës KI 269/23 me kërkesën KI 237/23.
16. Më 28 maj 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

17. Në fillim, para se t'i paraqesë faktet e rastit konkret, Gjykata duhet të sqarojë thelbin e rastit që i ka paraprirë procedurave pranë gjykatave të rregullta, në mënyrë që gjendja faktike të jetë më e qartë.

i) Procedura administrative

18. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës, për një periudhë kohore të caktuar, ka ushtruar detyrën e përmbaruesit privat. Më 29 dhjetor 2022, parashtruesi i kërkesës, në bazë të propozimit të kompanisë “Steel Comodies”, nga Republika e

Bullgarisë, inicioi procedurën përmbartimore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore “NewCo Lamkos Steel” L.L.C, e cila ishte në procedurën e likuidimit. Me këtë rast, sipas Urdhrit përmbartimor për transfer [nr. P. nr. 001/20] nga Banka Qendrore e Kosovës, nga llogaria bankare e Ndërmarrjes Shoqërore “NewCo Lamkos Steel” L.L.C. është transferuar shuma prej 3,500,632.50 € në llogarinë e përmbartuesit privat (parashtruesit të kërkesës). Duke pasur parasysh këtë, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), më 6 janar 2023, paraqiti në adresë të Ministrit të Drejtësisë dhe Odës së Përmbartuesve Privat, kërkesën në të cilën kërkoi iniciimin e procedurës disiplinore kundër parashtruesit të kërkesës. Në kërkesën e saj, AKP theksoi se përmbartuesi privat, me rastin e nxjerrjes së Urdhrit për transfer [nr. P. nr. 001/20], të cilin Banka Qendrore e aprovoi si të tillë dhe lejoi ekzekutimin-transferimin e shumës prej 3,500,632.50 €, ka kryer veprime të kundërligjshme të cilat janë në kundërshtim të plotë me aktet juridike dhe praktikën gjyqësore në lidhje me ekzekutimin/përmbartimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore, përfshirë edhe ato të arbitrazhit kur rasti ndërliidhet me fondet e ndërmarrjeve shoqërore në likuidim. Në këtë mënyrë, sipas pretendimeve të AKP-së, ekzekutimi është bërë jo vetëm në kundërshtim me Udhëzimin Juridik të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme C-IV-14-1607, të 15 tetorit 2015, por edhe në kundërshtim me nenin 10 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në dhe Sqarimin e Gjykatës Kushtetuese me [ref. 1010/II/nk], të 23 majit 2011. Gjithashtu, sipas AKP-së, përmbartuesi privat, në këtë rast, ka shkelur Ligjin nr. 04/L-034 për AKP-në, duke lëshuar Urdhrin për bllokimin e llogarisë bankare të Ndërmarrjes Shoqërore “New Co Lamkos”.

19. Më 23 shkurt 2023, Komisioni Disiplinor për Përmbartuesit Privat nxori Vendimin [DPL. nr. 01/2023] në të cilin theksoi se parashtruesi i kërkesës është përgjegjës për shkelje disiplinore, për shkak se gjatë kryerjes së veprimeve përmbartimore në kuadër të aktivitetit të tij, nuk i është përmbartur ligjit, në lëndën e përmbartimit [P. nr. 001/2020], *“prandaj të njëjtit i shqiptohet Masa disiplinore, Shkarkimi nga detyra”*.
20. Më 28 shkurt 2023, Ministria e Drejtësisë nxori Vendimin [nr. 54/2023] me të cilin vërtetoi Vendimin [nr. DPL.01/2023] e Komisionit Disiplinor për Përmbartuesit Privat.

ii) Procedurat gjyqësore

21. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore kundër Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionit Disiplinor për Përmbartuesit Privat, në të cilën kërkoi, **i)** anulimin e Vendimit [nr. 54/2023] të 28 shkurtit 2023 dhe Vendimit [DPL. nr. 01/2023] të 23 shkurtit 2023, si dhe **ii)** shtyrjen e ekzekutimit të tyre deri në përfundimin e procedurës gjyqësore në mënyrë meritore.
22. Andaj, ajo që Gjykata konstaton është se parashtruesi i kërkesës me kërkesëpadinë e tij kishte iniciuar dy procedura gjyqësore. Gjykata gjithashtu konstaton se gjykatat kanë vendosur vetëm për çështjen e kërkesëpadisë së dytë, përkatësisht për çështjen e **ii)** shtyrjes së ekzekutimit të vendimeve të Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionit Disiplinor për Përmbartuesit Privat dhe jo për çështjen e thelbit të padisë në fjalë lidhur me anulimin e vendimeve të kontestuara.
23. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata në vijim do të paraqesë vetëm gjendjen faktike lidhur me procedurën gjyqësore të zhvilluar nga gjykatat e rregullta për çështjen e **ii)** shtyrjes së ekzekutimit të vendimeve të Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionit Disiplinor për Përmbartuesit Privat.

Procedura gjyqësore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionit Disiplinor për Përmbaruesit Privat.

24. Parashtruesi i kërkesës në propozimin e tij nga padia për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionit Disiplinor për Përmbaruesit Privat, theksoi se atij “do t’i shkaktohet dëm i pariparueshëm sepse me mos shtyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi të kontestuar, ai është në mëshirën e Ministrisë së Drejtësisë ashtu që të gjitha lëndët përmbarimore që do t’i merren paditësit do t’i barten ndonjë përmbaruesi tjetër. Në këtë mënyrë paditësi nuk ka asnjë mundësi për kthimin e këtyre lëndëve edhe nëse anulohet vendimi kontestues. Prandaj si pasojë e bartjes së lëndëve si dhe si pasojë e mos ushtrimit të kësaj veprimtarie paditësi pëson dëm për shkak të pamundësisë së realizimit të të ardhurave për këtë veprimtari”.
25. Më 24 mars 2023, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [A. nr. 586/2023], me të cilin refuzoi si të pabazuar kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit [nr. 54/2023] të Ministrisë së Drejtësisë dhe Vendimit [DPL.br 01/2023] të Komisionit Disiplinor për Përmbaruesit Privat, duke theksuar:

“Gjykata konstatoi se pretendimet e paditësit/propozuesit janë të pa argumentuara me prova konkrete dhe si të tilla të pamjaftueshme dhe jo bindëse për të aprovuar kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të atakuar, për faktin se nuk janë përmbushur në mënyrë kumulative kushtet ligjore për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, padia referohet në fakte që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilën gjykata do të vendosë në mënyrë meritorë pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar. Paditësi nuk ka argumentuar se ekzekutimi do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, ngase kërkesa për shtyrje të ekzekutimit duhet argumentuar mbi baza reale të shkakut të dëmit të pariparueshëm [...]”.

“[...] gjykata këtu kishte në vëmendje interesin publik e i cili do të mund të cenohej më shumë si pasojë e vazhdimit të ushtrimit të aktiviteteve dhe nëse vendimet e atakuara do të rezultonin në fund të procesit si vendime të drejta dhe të ligjshme atëherë dëmi i shkakuar do të jetë më i madh për interesin publik[...]”.

26. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [A. nr. 586/2023] të Gjykatës Themelore, duke pretenduar vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
27. Më 24 prill 2023, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin [AA. nr. 240/2023], me të cilin refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [A. nr. 586/2023] e Gjykatës Themelore.
28. Në arsyetimin e Aktvendimit të saj [AA.nr. 240/2023], Gjykata e Apelit theksoi:

“[...] sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të përcaktuara me nenin 22 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe duke u nisur nga gjendja e tillë e

çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm një përfundim të tillë të Gjykatës së shkallës së parë.

“[...] me nenin 22 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative është përcaktuar se shtyrja e ekzekutimit të vendimit mund të bëhet, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret, paditësi-propozuesi me ankesën e ushtruar kërkon shtyrjen e ekzekutimit të akteve administrative me arsyetimit se “Paditësi në ushtrimin e veprimtarisë së tij si përmbarues privat ka realizuar të hyra të konsiderueshme nga aktiviteti i ligjshëm. Referuar Formularit të Deklarimit Vjetor dhe pagesës për Tatimin në të Ardhurat[...]”.

“[...] paditësi-propozuesi nuk ka ofruar prova për të vërtetuar plotësimin e tre kushteve të parapara në mënyrë kumulative për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të kontestuar, siç përcaktohet me nenin 22 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Kjo për faktin se kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve kryesisht është e mbështetur në fakte dhe prova që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, përkatësisht objektin e kërkesëpadisë së paditësit, për të cilat Gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të padisë për anulimin e vendimeve të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve. Prandaj, nëse Gjykata në rastin e vendosjes sipas padisë së paditësit, gjen se vendimet e të paditurës janë të paligjshme, atëherë qfarëdo dëmi eventual i shkaktuar ndaj paditësit mund të llogaritet dhe mund të kompensohet”.

29. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi në Gjykatën Supreme propozimin për shqyrtim të jashtëzakonshëm të aktvendimit [AA. nr. 240/2023] të Gjykatës së Apelit të 24 prillit 2023, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore si dhe shkelje të së drejtës materiale.
30. Më 17 gusht 2023, Gjykata Supreme nxori aktvendimin [ARJ. nr. 112/2023], me të cilin refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për shqyrtim të jashtëzakonshëm të aktvendimit [AA. nr. 240/2023] të Gjykatës së Apelit të 24 prillit 2023.
31. Në arsyetimin e aktvendimit Gjykata Supreme *inter alia* deklaroi:
 - a) Lidhur me plotësimin e kushteve të parapara me nenin 22 paragrafi 2 të LKA-së, konkluzioni i Gjykatës Supreme ishte:

“me nenin 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet se me kërkesën e paditësit-ses akti i organit i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund të shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrative do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Ndërsa me dispozitën e nenit 22, paragrafi 6, të njëjtit ligj përcaktohet se, paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësi nuk arrin të dëshmojë me prova bindëse

mbështetjen e kërkesës së tij, se me ekzekutimin e vendimit të organit administrativ do ti shkaktohej dëm i cili vështirë do të riparohej, që shtyrja pezullimi i ekzekutimit të vendimit të kontestuar nuk është në kundërshtim me interesin publik, dhe shtyrja nuk do ti shkaktonte dëm të pa riparueshëm apo të madh palës kundërshtare-kundër propozuesit, përkatësisht palës së interesuar. Pra [...] nuk janë plotësuar kushtet ligjore si parashihen në nenin 22 të LKA-së në mënyrë kumulative [...]

- b) Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjykata e Apelit dhe ajo Themelore nuk i kanë shqyrtuar me kujdes provat dhe se aktvendimet nuk janë arsyetuar në pajtim me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata Supreme erdhi në përfundimin:

“Argumentet dhe provat në të cilat thirret paditësi në kërkesë e në të cilat është bazuar edhe në ankesë dhe gjykatën e shkallës së parë në propozim për shtyrje dhe në bazë të cilave pretendon se i shkaktohet dëm i cili vështirë do të riparohej [...] kolegji po ashtu u refuzon si jo të qëndrueshme dhe me ndikim për të vendosur ndryshe nga e vendosur nga gjykatat e instancave më të ulëta, sepse këto pretendime nuk janë të besueshme dhe argumentuara me prova konkrete dhe fakte, në bazë të cilave dëshkohet se paditësi i shkaktohet dëm i cili vështirë do të riparohej gjer në vendosjen meritore të çështjes...”

Pretendimi se vendimi nuk është i arsyetuar dhe nuk korrespondon me përmbajtjen e shkresave të lëndës, kolegji i Gjykatës Supreme i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme dhe të bazuara, sepse janë të paraqitura në mënyrë deklarative dhe të përgjithësuara, pa u bazuar në prova dhe argumente të qëndrueshme për të vendosur ndryshe nga ajo e vendosur nga gjykatat e instancave më të ulëta. Andaj nuk rezultojnë se vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta nuk janë të arsyetuar mjaftueshëm me refuzimin e propozimit të paditësit për tu shtyrë ekzekutimi i vendimeve të organit të paditur gjer në vendosjen meritore.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me kërkesën KI 237/23

32. Parashtruesi në lidhje me kërkesën KI237/23 theksoi se vendimi [nr. 54/2023] i Ministrisë së Drejtësisë dhe Vendimi [DPL. nr. 01/2023] i Komisionit Disiplinor për Përmbaruesit Privat, shkelin të drejtat e tij, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së.

i) *Pretendimet për shkelje të neneve të Kushtetutës dhe KEDNJ-së*

33. Parashtruesi i kërkesës e arsyeton shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, me pretendimin se gjatë procedurës disiplinore ndaj tij nuk janë zbatuar garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së. Më konkretisht se, “Komisioni Disiplinor, mes tjerash, është dashur të jetë i pavarur dhe i paanshëm në vendosjen e çështjes së Parashtruesit. Komisioni Disiplinor nuk ishte i tillë. Megjithëse të metat e tilla do të mund të mënjanoheshin po që se kontrolli i mëpastajshëm i asaj ndërhyrjeje do bëhej nga një organ gjyqësor me juridiksion të plotë dhe që përmbushë të gjitha garancionet e nenit 6, një kontroll i tillë nuk ka ndodhur në rast konkret, edhe për shkak të mjeteve juridike

në dispozicion që nuk ishin efektive për Parashtruesin, siç janë elaboruar më lart në pjesën përkatëse. Prandaj, çështja që shtrohet në rastin konkret është nëse, vetvetiu, Komisioni Disiplinor përmbushte garancionet nga neni 6 (1), përkatësisht që të ishte një "gjykatë" e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".

34. Shkeljen e nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës e arsyeton me pretendimin se, *"shkarkimi i tij nga detyra përmes vendimeve të kontestuara ka bërë që ai fillimisht të ketë pasoja serioze, sidomos për shkak të përkeqësimit të gjendjes së tij financiare. Ai realizonte të hyra të konsiderueshme nga puna e tij si përmbarues privat (vitet e fundit, rreth 20.000 € në muaj) dhe me shkarkimin e tij është përkeqësuar skajshmërisht mirëqenia e tij materiale dhe standardi i jetesës që kishte ai dhe familja e tij para ndërhyrjes së autoriteteve publike".*
35. Prandaj, parashtruesi i kërkesës konsideron se përmes vendimeve të kontestuara ka pasur ndërhyrje në të drejtën e tij për respektimin e jetës private, por që, si në çdo rast tjetër, *"kjo ndërhyrje duhet 1) të jetë e bazuar në ligj, 2) të ndjekë një qëllim legjitim, si dhe 3) të jetë e nevojshme në një shoqëri demokratike".* Megjithatë, parashtruesi i kërkesës konsideron se në rastin e tij, *"Ndërhyrja në të drejtën për respektim të jetës private të parashtruesit në rastin konkret nuk ishte "në pajtueshmëri me ligjin", për arsytet si vijon. Siç kemi theksuar më lart, kjo shprehje nuk nënkupton thjesht që ndërhyrja të jetë e bazuar në ligj, por ajo i referohet edhe kualitetit të ligjit, i cili duhet të jetë i qartë, i qasshëm dhe i parashikueshëm, në mënyrë që t'u mundësojë individëve të veprojnë duke respektuar ligjin dhe ta kenë të qartë se, nën cilat kushte dhe rrethana, autoritetet publike mund të ndikojnë në të drejtat e tyre..."*.
36. Parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu shkelje të nenit 49 të Kushtetutës dhe e ndërlihd këtë shkelje me faktin se, *"Kushtetuta e Kosovës garanton të drejtën e punës dhe ushtrimin të profesionit pa marr parasysh pasojat që mund të ketë pasur shkarkimi nga detyra në jetën private, si dhe pa marr parasysh pragun e seriozitetit që mund të ketë sjellë ndërhyrja në fjalë. Prandaj, sipas Kushtetutës së Kosovës, çdo veprim i autoriteteve publike që cenon të drejtën e punës dhe ushtrimin të profesionit do të konsiderohet ndërhyrje, duke sjellë pas vetës implikacionet përkatëse kushtetuese".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me kërkesën KI269/23

37. Parashtruesi në lidhje me kërkesën KI269/23 deklaroi se përmes aktvendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta, atij i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
38. Në mbështetje të shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës konsideron se *"aktvendimi i kontestuar cenon garancionet nga neni 6(1) për shkak se ka arsyetim të mangët, përkundër kërkesave të qarta kushtetuese. Vendimi i Gjykatës Supreme (ashtu sikurse edhe i shkallëve më të ulëta) vetëm me një gjuhë tejet të përgjithësuar dhe abstrakte flasin se si Parashtruesi i Kërkesës nuk ka argumentuar mjaftueshëm dhe me prova bindëse se janë plotësuar kushtet nga LKA për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Aktvendimi i kontestuar nuk jep kurrfarë arsytimi domethënës dhe bindës lidhur me atë se përse Parashtruesi nuk ka arritur të dëshmojë me prova bindëse se janë plotësuar të gjitha kushtet kumulative nga neni 22 i LKA".*

Pretendimet lidhur me kërkesën për masë të përkohshme

39. Sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, “masa e përkohshme në këtë çështje jo vetëm që është e nevojshme për të parandaluar dëmin dhe rreziqet e pariparueshme për parashtruesin, siç është argumentuar në kërkesë, por vendosja e masës së përkohshme është edhe në interesin publik. Është në veçanti në interesin publik që një profesion i lirë në Kosovë, siç është ai i përmbaruesit privat, të mos denigrohet nga institucionet ekzekutive në një mënyrë të tillë krejtësisht arbitrare dhe qartazi jokushtetuese, pa garancione minimale për punën e tyre të pavarur”.
40. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën që ajo, I. të deklarojë kërkesën e tij të pranueshme, II. të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 36 [E Drejta e privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; si dhe të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës; III. të shpallë të pavlefshëm Vendimin e Komisionit Disiplinor për Përmbaruesit Privat DPL nr. 01/2023, si dhe Vendimin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 54/2023.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik osesigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

[...]“

Neni 36

[E Drejta e Privatësisë]

- “1. Çdokush gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.
2. Kontrollat e cilësdo banese ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratoj veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.
3. Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të

vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.

4. Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj.”

Neni 49

[E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

“1. E drejta e punës garantohehet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohehet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë”.

Neni 8

(E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve”.

Ligji nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative

Neni 22

“[...]

2. Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohet, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”.

[...]

Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

160
[pa titull]
[...]

“160.4 Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.

160.5 Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor.”

Shkaqet nga të cilat mund të goditet aktgjykimi

182
[pa titull]

[...]

“n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

41. Gjykata fillimisht vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar me tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1.Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]”

43. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individu mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

44. Gjykata, gjithashtu, shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafin (1) (b) të Rregullores së punës. Ato përcaktojnë si në vijim:

Neni 49 i Ligjit
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

Rregulli 34 i Rregullores së punës
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj kundër aktit të kontestuar;

[...]”.

45. Megjithatë, para se Gjykata të vazhdojë me procedimin e mëtejshëm të të dyja kërkesave, duhet të përmend faktin se kur parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesën e dytë KI269/23, ai përmes saj, ndër të tjera, kërkoi që “Gjykata ta injorojë kërkesën e mëparshme”, përkatësisht kërkesën që Gjykata e regjistroi me numrin KI237/23.

46. Gjykata vëren se në rregullin 31. 1 [Tërheqja e palëve nga procedura] e Rregullores së punës thuhet:

“Parashtruesi/ja e kërkesës mund të tërheqë kërkesën në çdo kohë para shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Gjykatës”.

47. Megjithatë, pavarësisht mundësisë së tërheqjes së kërkesës, vetëm kërkesa deklarative e parashtruesit të kërkesës nuk mjafton që Gjykata të veprojë në lidhje me të. Prandaj, në vijim Gjykata do t'i shqyrtojë të dyja kërkesat e paraqitura ndarazi .

48. Në mbështetje të kësaj, në mënyrë që Gjykata të vazhdojë me analizën e kërkesës KI273/23 dhe KI269/23, ajo duhet të konstatojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në secilën kërkesë të parashtruar ndarazi, siç përcaktohet në rregullin 34 paragrafin (1) (b) të Rregullores së punës. Prandaj, Gjykata do të vlerësojë individualisht edhe këtë aspekt procedural të kërkesave të parashtruara.

Vlerësimi i përmbushjes së kushteve të kërkesës KI237/23 në lidhje me përmbushjen e kushteve të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës

49. Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 34 (1) (b) të Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.
50. Në mbështetje të kësaj, Gjykata së pari thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për shkak të mos shterjes së mjeteve juridike. Më saktësisht, bazuar në nenin 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, Gjykata mund të deklarojë një kërkesë të papranueshme nëse gjatë vlerësimit paraprak konstaton se kërkesa e parashtruar qartazi nuk i plotëson kriteret procedurale për parashtrim, siç përcaktohet me nenin 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës.
51. Pikërisht në lidhje me këtë, Gjykata thekson se kriteret e vlerësimit nëse detyrimet për shterimin e të gjitha “mjeteve efektive juridike” janë mirë të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
52. Gjykata rikujton se praktika e GJEDNJ-së dhe ajo e kësaj Gjykate njohin tri kategori të rasteve kur kërkesa e parashtruar mund të deklarohet e papranueshme për shqyrtim për shkak të mos shterjes së mjeteve juridike, e ato janë: **i**) “mos shterimi në aspektin procedural” (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Civet kundër Francës](#) [DHM], nr. 29340/95, Aktgjykim i 28 shtatorit 1999, paragrafi 41; Komisioni për të Drejtat e Njeriut, [Dornbach kundër Republikës Federale të Gjermanisë](#), nr. 11258/84, Vendim i 7 korrikut 1986, paragrafi 5; [Demopoulos dhe të tjerët kundër Turqisë](#) [DHM], nr. 46113/99, Vendim, paragrafët 69 dhe 97), **ii**) “mos shterimi në aspektin substancial” (shih rastet e GJEDNJ-së, [Haxhia kundër Shqipërisë](#), nr. 29861/03, Aktgjykim i 8 tetorit 2013, paragrafët 149 dhe 152; [Castells kundër Spanjës](#), nr. 11798/85, Aktgjykim i 23 prillit 1992, paragrafi 32; [Ahmet Sadik kundër Greqisë](#), nr. 18877/91, Aktgjykim i 15 nëntorit 1996, paragrafi 33; [Gäfgen kundër Gjermanisë](#) [DHM], nr. 22978/05, Aktgjykim i 1 qershorit 2010, paragrafët 142, 144 dhe 146), dhe, **iii**) “kërkesë e parakohshme” (shih rastet e GJEDNJ-së, [Bilsena ŠAHMAN kundër Bosnjës dhe Hercegovinës](#), nr. 40110/16, Vendim i 25 prillit 2017; [Mirazović kundër Bosnjës dhe Hercegovinës](#), nr. 13628/03, Vendim i 16 majit 2006).

53. Në rastin konkret, Gjykata nga gjendja faktike konkludoi se parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesëpadinë në Gjykatën Themelore në të cilën kërkoi anulimin e Vendimit [nr. 54/2023] të Ministrisë së Drejtësisë, të 28 shkurtit 2023, dhe Vendimit [DPL. nr. 01/2023] të Komisionit Disiplinor për Përmbaruesit Privat, të 23 shkurtit 2023, lidhur me shkarkimin e tij nga detyra e përmbaruesit privat, të cilin ai pikërisht e konteston në kërkesën e tij. Po kështu, Gjykata nga pretendimet nga kërkesa, konkludoi se shkeljen e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës e ndërlihd vetëm me këto vendime.
54. Megjithatë, Gjykata rikujton se procedura gjyqësore e cila ka të bëjë me anulimin e Vendimit [nr. 54/2023] të Ministrisë së Drejtësisë dhe Vendimit [DPL. nr. 01/2023] të Komisionit Disiplinor për Përmbaruesit Privat, aktualisht është në fazën e shqyrtimit në gjykatate rregullta, dhe se pikërisht vendimet e kontestuara, kushtetutshmërinë e të cilave e kërkon parashtruesi para kësaj Gjykate, do t'i nënshtrohen kontrollit dhe vlerësimit nga gjykatat e rregullta.
55. Në këtë mënyrë, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre përmes procedurave gjyqësore të rregullta para se rasti të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar, pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në të drejtën nacionale apo jo (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, [Aksoy kundër Turqisë](#), Aktgjykim i 18 dhjetorit 1996, paragrafi 51).
56. Në mbështetje të sa më sipër, Gjykata rikujton se parimi i shterimit të mjeteve juridike nënkupton që mekanizmi për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese i krijuar nga Gjykata Kushtetuese të jetë subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, [Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), Aktgjykim i GJEDNJ-së i 7 dhjetorit 1976, paragrafi 48).
57. Prandaj, duke i ndërlihdur parimet dhe principet e lartpërmendura me gjendjen faktike të kërkesës, rezulton se është më se e qartë se në rastin konkret gjykatat e rregullta ende nuk kanë vendosur për çështjen e anulimit të vendimeve të kontestuara, të cilat parashtruesi në kërkesën e tij i ndërlihd me shkeljen e të drejtave dhe lirive të tij kushtetuese.
58. Rrjedhimisht, në rrethanat e këtij rasti, bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjykata është e detyruar që kërkesën e parashtruesit ta deklarojë të papranueshme, si të parakohshme, sepse në rastin e tij nuk janë shteruar mjetet efektive juridike, përkatësisht nuk janë përmbushur kriteret e paragrafit (1) (b) të rregullit 34 të Rregullores së punës në mënyrë që Gjykata ta shqyrtojë këtë kërkesë të parashtruesit të kërkesës.
59. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata konstaton se para gjykatave të rregullta është ende duke u zhvilluar procedura gjyqësore e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës në të cilën ka kërkuar anulimin e vendimeve të kontestuara. Kjo e cilëson kërkesën konkrete të parashtruesit si kërkesë të kategorisë **iii**) “kërkesë e parakohshme”, gjë që është në pajtim me praktikën e përmendur të GJEDNJ-së (shih rastet specifike të GJEDNJ-së, [Bilsena ŠAHMAN kundër Bosnjës dhe Hercegovinës](#), nr. 40110/16, Vendim i 25 prillit

2017; *Mirazović kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, nr. 13628/03, Vendim i 16 majit 2006).

60. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit KI 237/23 cilësohet si “kërkesë e parakohshme”, dhe rrjedhimisht ajo hedhet poshtë në pajtim me nenin 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Vlerësimi i përmbushjes së kushteve të kërkesës KI 269/23 në lidhje me përmbushjen e kushteve të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës

61. Gjykata, duke shqyrtuar nëse kërkesa KI269/23 e parashtruesit të kërkesës i ka plotësuar kushtet e parapara lidhur me shterimin e mjeteve juridike, konstaton se parashtruesi në kërkesën e përmendur e konteston procedurën gjyqësore të cilën e ka iniciuar në Gjykatën Themelore përmes të cilës ka kërkuar, **ii**) shtyrjen e ekzekutimit të vendimit [nr. 54/2023] të Ministrisë së Drejtësisë të 28 shkurtit 2023 dhe vendimit [DPL. nr. 01/2023] të Komisionit Disiplinor për Përmbaruesit Privat të 23 shkurtit 2023, lidhur me shkarkimin e tij nga pozita e përmbaruesit privat deri në përfundimin e procedurës gjyqësore në merita.
62. Gjykata konstaton se ajo procedurë ka përfunduar me aktvendimin [ARJ 112/2023] e Gjykatës Supreme të 17 gushtit 2023. Rrjedhimisht, rezulton se parashtruesi në kërkesën KI269/23 ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj në pajtim me kërkesat e nenit 47 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës, që i mundëson Gjykatës të vazhdojë me analizën e mëtejshme të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.
63. Prandaj, Gjykata, lidhur me plotësimin e kriterëve të cekura të kërkesës KI 269/23, vlerëson se parashtruesi i kërkesës është: (i) person i autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; (ii) konteston kushtetutshmërinë e aktvendimit [ARJ 112/2023] të Gjykatës Supreme të 17 gushtit 2023; (iii) se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit; (iv) se ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe (v) se e ka parashtruar kërkesën brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet në nenin 49 të Ligjit.
64. Përveç kriterëve të lartpërmendura, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë kriterin që kërkesa nuk është qartazi e pabazuar. Ky rregull shprehimisht përcakton si në vijim:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.”

65. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e rastit. Më konkretisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastet e Gjykatës: [KI04/21](#), parashtruese [Nexhmije Makolli](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 25 dhe [KI29/22](#), parashtrues [“Kosovska Banka” DD Beograd](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 11 korrikut 2023, paragrafi 61; dhe [KI122/22](#) parashtrues [Ilaz Rrahmani](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 5 korrikut 2023, paragrafi 38).
66. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, këtyre pretendimeve do të ju referohemi si “pretendime qartazi të pabazuara” dhe bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të njëjtat kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura ose të paarsyetuara”; dhe në fund pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, ndër të tjera rastet e GJEDNJ-së [Kemmachev kundër Francës](#), kërkesa nr. [17621/91](#), kategoria (i); [Mentzen kundër Letonisë](#), kërkesa nr. [71074/01](#), kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), kërkesa nr. [4241/03](#), kategoria (iii)).
67. Gjykata thekson se gjatë vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, gjatë vlerësimit nëse pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, së pari do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës. Në vlerësimin e pretendimeve të tilla, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, nen, i cili e detyron Gjykatën të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të Kushtetutës në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.
68. Gjykata rikujton se gjykatat e rregullta në procedurën konkrete të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës vendosën ekskluzivisht përkitazi me kërkesëpadinë në lidhje me **ii**) shtyrjen e ekzekutimit të vendimit [nr. 54/2023] të Ministrisë së Drejtësisë të 28 shkurtit 2023 dhe vendimit [DPL. nr. 01/2023] të Komisionit Disiplinor për Përmbaruesit Privat të 23 shkurtit 2023 deri në përfundimin e kërkesëpadisë kryesore lidhur me ligjshmërinë e tyre.
69. Në bazë të kësaj, rrjedh se propozimi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve hyn në fushëveprimin e “procedurës paraprake”, Rrjedhimisht, Gjykata do të vlerësojë nëse neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është i aplikueshëm në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës.
70. Në këtë kontekst specifik, Gjykata vëren se çështja e aplikueshmërisë së nenit 6 të KEDNJ-së në procedurën paraprake është interpretuar nga GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, në harmoni me të cilën Gjykata, në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e obliguar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

71. Gjykata gjithashtu thekson se kriteret në lidhje me aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me procedurat paraprake janë përcaktuar gjithashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por pa u kufizuar në rastet [KI195/20](#), parashtrues, *Aigars Kesengfelds*, Aktgjykim, i 29 marsit 2021, [KI75/21](#), parashtrues “*Abrazen LLC*”, “*Energy Development Group Kosova LLC*”, “*Alsi & Co. Kosovë LLC*” dhe “*Building Construction LLC*”, aktgjykim i 19 janarit 2022, KI 202/21, parashtrues „*Kelkos Energy*“ sh.p.k, aktgjykim i 29 shtatorit 2022 dhe KI143/22, parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, aktgjykim i 15 dhjetorit 2022. Parimet e përgjithshme të cilat Gjykata i ka zbatuar në vendimet e sipërpërmendura bazohen në rastin e GJEDNJ-së [Micallef kundër Maltës](#), aktgjykim i 15 tetorit 2009.
72. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata thekson se jo të gjitha masat e sigurisë apo masat e përkohshme përcaktojnë të drejtat ose detyrimet civile dhe në mënyrë që neni 6 i KEDNJ-së të konsiderohet i aplikueshëm, GJEDNJ përcaktoi kriteret mbi bazën e të cilave duhet të vlerësohet aplikueshmëria e nenit 6 të KEDNJ-së në “*proceduarën paraprake*” (shih rastin e GJEDNJ-së, [Micallef kundër Maltës](#), cituar më lart, paragrafët 83-86).
73. Sipas kriterëve të përcaktuara në rastin *Micallef kundër Maltës*, të cilat kriteret edhe kjo Gjykatë i pranoi përmes praktikës së saj gjyqësore:
- i) së pari, e drejta në fjalë duhet të jetë “*civile*” sipas KEDNJ-së, si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në procedurat lidhur me masën e sigurisë, brenda kuptimit autonom të këtij nocioni sipas nenit 6 të KEDNJ-së; dhe
 - ii) së dyti, kjo procedurë duhet të përcaktojë në mënyrë efektive të drejtën civile përkatëse. Sa herë që një masë e përkohshme mund të konsiderohet efektive për përcaktimin e së drejtës ose detyrimit civil në fjalë, neni 6 do të jetë i aplikueshëm pavarësisht nga kohëzgjatja e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, [Micallef kundër Maltës](#), të cituar më lart, paragrafët 84-85 dhe referencat e përmendura aty).
74. Rrjedhimisht, për të konstatuar nëse në rastin konkret aplikohet neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, Gjykata do t’iu referohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për sa i përket aplikueshmërisë së garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe më pas të njëjtat do t’i aplikojë në rrethanat e rastit konkret.
75. Gjykata rikujton se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës ka iniciuar procedurë gjyqësore me kërkesëpadi, përmes së cilës ka kërkuar, **i)** anulimin e vendimeve [nr. 54/2023] të 28 shkurtit 2023 dhe [DPL. nr. 01/2023] të 23 shkurtit 2023, dhe **ii)** shtyrjen e ekzekutimit të tyre deri në përfundimin e procedurës gjyqësore në merita.
76. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht vëren se thelbi i së drejtës në fjalë në procedurën kryesore (shqyrtimi i meritave) ndërlidhet me ligjshmërinë e vendimeve në lidhje me “*Shkarkimin nga detyra*”, si dhe me anulimin e tyre. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se e drejta në fjalë, si në merita po ashtu edhe në procedurën paraprake, në rrethanat e rastit konkret, përfshin të drejtën e natyrës civile.

77. Së dyti, Gjykata vëren gjithashtu se çështja e shtyrjes së ekzekutimit të vendimeve [nr. 54/2023] të 28 shkurtit 2023 dhe [DPL. nr. 01/2023] të 23 shkurtit 2023, përcakton në mënyrë efektive të drejtën civile në fjalë.
78. Prandaj, duke marrë parasysh të drejtën e përfshirë në “*procedurat paraprake*”, përkatësisht masën e përkohshme dhe natyrën e saj vendimtare për të drejtën civile në fjalë, Gjykata konstaton se rrethanat e rastit konkret plotësojnë kriteret për zbatimin e garancive procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
79. Rrjedhimisht, Gjykata, duke shqyrtuar më konkretisht pretendimet e parashtruesit e kërkesës në kontekst të shkëljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, konstaton se parashtruesi i kërkesës shkëljet e përmendura të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së i ndërlidh me “*arsyetim të mangët në vendimet e Gjykatës Supreme ashtu sikurse edhe i shkallëve më të ulëta, të cilët vetëm me një gjuhë tejet të përgjithësuar dhe abstrakte flasin se si Parashtruesi i Kërkesës nuk ka argumentuar mjaftueshëm dhe me prova bindëse se janë plotësuar kushtet nga LKA për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit*”. Përkatësisht, aktvendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta nuk ofrojnë ndonjë arsyetim të rëndësishëm dhe bindës se pse parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë me prova bindëse se janë plotësuar të gjitha kushtet kumulative nga neni 22, paragrafi 2 i LKA-së.
80. Prandaj, nga pretendimet e parashtruesit të kërkesës, është e qartë se ai e ndërlidh shkëljen e së drejtës për gjykim të drejtë me aktvendimet e paarsyetuara të gjykatave të rregullta. Prandaj, Gjykata rikujton se neni 6 paragrafi 1 i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih rastet e GJEDNJ-së, [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, aktgjykim i 29 janarit 1999, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).
81. Përveç kësaj, e drejta për një vendim të arsyetuar është pjesë e pandashme e së drejtës për një gjykim të drejtë, e cila i detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, sepse mungesa e arsyeve të mjaftueshme dhe relevante në vendimin e gjykatës mund të tregojë, ndër të tjera, vendimmarrje arbitrare gjyqësore. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se gjykatat janë të detyruara t'i përgjigjen në mënyrë të detajuar çdo argumenti të paraqitur nga palët në procedurë, përkatësisht në ankesa ose parashtrësia të tjera përkatëse, por duhet t'u përgjigjen atyre argumenteve që janë kyçe dhe vendimtare për marrjen e një vendimi (shih GJEDNJ, [Ajdarić kundër Kroacisë](#), aktgjykim i 13 dhjetorit 2011, kërkesa numër 20883/09, paragrafi 34).
82. Gjykata, duke iu rikthyer thelbit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe duke i shqyrtuar ato në kontekst të vendimit të Gjykatës Themelore në lidhje me mënyrën se si e ka arsyetuar mosplotësimin e kushteve të parapara me nenin 22.2 të LKA-së, vëren se është fakt që Gjykata Themelore e ka bazuar aktvendimin e saj për refuzimin e propozimit për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve në atë se kushtet që do të justifikonin propozimin e parashtruesit të kërkesës nuk ishin plotësuar në mënyrë kumulative. Në mbështetje të kësaj, Gjykata vëren se neni 22 paragrafi 2 i LKA-së i jep parashtruesit të kërkesës mundësinë për të paraqitur kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit,

megjithatë i njëjti nen në paragrafin 2 të LKA-së gjithashtu e detyron parashtruesin e kërkesës të paraqesë prova mjaft bindëse për të arsyetuar propozimin e tij. Prandaj, detyrimi për paraqitjen e provave dhe argumenteve kalon në përgjegjësinë e tij në procedurën e vërtetimit të domosdoshmërisë që propozimi i tij për shtyrje të miratohet.

83. Gjykata gjithashtu konstaton se parashtruesi i kërkesës ka vepruar pikërisht sipas kërkesave të nenit 22, paragrafi 2 i LKA-së, duke propozuar prova, të cilat sipas mendimit të tij janë të mjaftueshme për miratimin e propozimit të tij. Mirëpo, edhe përkundër këtij fakti, siç vëren Gjykata, Gjykata Themelore me rastin e vlerësimit të provave ka ardhur në përfundim *“se pretendimet e paditësit/propozuesit janë të pa argumentuara me prova konkrete dhe si të tilla të pamjaftueshme dhe jo bindëse për të aprovuar kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të atakuar, për faktin se nuk janë përmbushur në mënyrë kumulative kushtet ligjore për shtyrje të ekzekutimit të vendimit”*.
84. Gjykata rikujton se, sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës Kushtetuese, detyrë e këtyre gjykatave nuk është të rishqyrtojnë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e së drejtës (shih GJEDNJ, [Pronina kundër Ruisë](#), vendim për pranueshmëri i 30 qershorit 2005, kërkesa numër [65167/01](#)). Në të vërtetë, Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente që t'i zëvendësojë gjykatat e rregullta në vlerësimin e fakteve dhe provave, por, është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i vlerësojnë faktet dhe provat të cilat i kanë administruar (shih GJEDNJ, [Thomas kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), aktgjykim i 10 majit 2005, kërkesa numër [19354/02](#)).
85. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se Gjykata Themelore ka vepruar në pajtim me parimin e lartpërmendur të GJEDNJ-së, me ç' rast ka vlerësuar provat dhe materialin dëshmues të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës me propozimin për shtyrjen e vendimve duke ka ardhur në përfundimin se me ato prova, parashtruesi i kërkesës nuk argumentoi se *“ekzekutimi do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohet, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar”*, sepse kërkesa për shtyrje të ekzekutimit duhet të argumentohet në baza reale *“të shkaktimit të dëmit të riparueshëm, vlera e të cilës është e pa kompensueshme në kuptimin material dhe monetar, e që paditësi pretendimet e tij referon në dëme financiar”*.
86. Prandaj, nga shpjegimi i lartpërmendur i një pjese të aktvendimit të Gjykatës Themelore, është më se e qartë se Gjykata Themelore ka bërë një vlerësim të detajuar të përmbushjes së kushteve të parapara me nenin 22 paragrafi 2 të LKA-së në lidhje me cilësinë e provave, duke konkluduar se ai (parashtruesi i kërkesës) nuk arriti të bindë me prova Gjykatën se ekzekutimi i vendimit do t'i shkaktonte atij *“dëm të riparueshëm”*, përkatësisht se vetëm ekzekutimi i vendimit nuk i shkaktonte atij dëm të riparueshëm në aspektin material apo monetar, për arsye se, siç deklaroi Gjykata Themelore, çka nëse në përfundim të procedurës gjyqësore vjen në përfundim se vendimet e kontestuara janë të kundërligjshme, *“atëherë dëmi i pretenduar do të mund të përcaktohet për kompensim me vendimin përfundimtar gjyqësor varësisht nga kërkesat në procedurë gjyqësore”*.
87. Për më tepër, Gjykata Themelore shqyrtoi edhe çështjen nëse ekzekutimi i vendimit do të ndikonte në interesin publik si dhe në buxhetin e Kosovës si pjesë e kushteve kumulative të përcaktuara me nenin 22 paragrafi 2 të LKA-së, siç thekson parashtruesi i kërkesës, ku ai solli interesin publik në lidhje me pasojat që mund të pësonin palët e tij që ai përfaqëson. Ato pretendime kanë qenë të pabazuara edhe për Gjykatën Themelore, për

faktin, siç gjykata ka deklaruar, sepse pikërisht ajo ka parasysh mbrojtjen e interesit publik që mund të ishte rrezikuar edhe më shumë si pasojë e vazhdimit të veprimtarisë së tij, sepse *“nëse vendimet e atakuar do të rezultojnë në fund të procesit si vendime të drejta dhe të ligjshme atëherë dëmi i shkaktuar do të jetë më i madhe si për interesin publik dhe po ashtu dhe për palët e përfshira në procedurë në raport me kërkesën eventuale për kompensim të këtu paditësit”*.

88. Gjukata gjithashtu konstaton se Gjukata Themelore shtjelloi edhe pretendimin ankimor në raport me pohimin e parashtruesit të kërkesës *“që shtyrja do të sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare”*, duke konstatuar se një pretendim i tillë është i pabazuar, për çka gjykata dha edhe arsyetim të detajuar.
89. Përveç kësaj, është e qartë për Gjukatën se Gjukata Themelore shqyrtoi tërë materialin dëshmues duke arritur në përfundim se një pjesë e materialit dëshmues të parashtruesit të kërkesës përmban gjithashtu prova që kanë të bëjnë me vërtetimin e përmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 22 paragrafin 2 të LKA-së, por që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe se si të tilla nuk mund të merren në shqyrtim në këtë fazë të procedurës për të mos paragjykuar çështjen kryesore për të cilën gjykatat ende nuk kanë nxjerrë aktgjykim.
90. Përveç kësaj, në lidhje me çështjen e arsytimit të aktvendimit të Gjukatës së Apelit në kontekst të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjukata konstaton se Gjukata e Apelit gjithashtu shqyrtoi në tërësi të gjitha pretendimet ankimore si dhe provat e paraqitura, të cilat sipas parashtruesit të kërkesës, arsyetojnë kërkesën e tij për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Gjukata gjithashtu konstaton se Gjukata e Apelit ka arritur në përfundime në mbështetje të kësaj, nga të cilat,
 - i) përfundimi i parë për vlerësimin e përmbushjes së kërkesave të nenit 22 paragrafi 2 i LKA-së, duke konstatuar se të njëjtat janë të pabazuara dhe të paargumentuara me prova konkrete në mënyrë që të aprovohej ankesa dhe të lejohej shtyrja e vendimeve të kontestuara deri në marrjen e vendimit sipas padisë së parashtruesit të kërkesës.
 - ii) përfundimi i dytë se propozimi i parashtruesit të kërkesës mbështetet kryesisht në fakte dhe prova që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, gjegjësisht objektin e kërkesëpadisë së paditësit, për të cilën gjykata do të vendosë në merita pas paraqitjes së provave dhe shqyrtimit të padisë për anulimin e vendimeve të kontestuara, por që tani nuk kanë ndikim në vlerësimin e besueshmërisë së kërkesave për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve.
91. Gjithashtu, as në aktvendimin e Gjukatës Supreme, Gjukata nuk gjen ndonjë argument në favor të parashtruesit të kërkesës, për arsye se, pasi ka vlerësuar pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës, gjykata konstatoi se paditësi-propozuesi nuk ka ofruar prova për të vërtetuar plotësimin e tri kushteve kumulative për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, siç përcaktohet me nenin 22, paragrafi 2 të LKA-së.
92. Për më tepër, Gjukata konstaton se Gjukata Supreme i ka vlerësuar edhe provat plotësuese të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës më 22.06.2023, 21.07.2023 dhe 24.07.2023, për të arsyetuar bazueshmërinë e kërkesës së tij, ku Gjukata Supreme konkludoi se këto prova dhe dokumente të tjera që i bashkëngjiten padisë dhe ankesës të dërguar në gjykatë, nuk janë prova me ndikim që të aprovohet masa e përkohshme dhe të shtyhet ekzekutimi i vendimeve të organit të paditur deri në marrjen e vendimit për

çështjen kryesore, dokumente që mund të shqyrtohen dhe vlerësohen gjatë vendimmarrjes në merita të çështjes sipas padisë.

93. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se janë të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës se aktvendimet e gjykatave të rregullta nuk janë arsyetuar mjaftueshëm lidhur me përmbushjen e kushteve të nenit 22 paragrafi 2 të LKA-së, përmes të cilave janë shkelur të drejtat e tij nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Përfundim

94. Në fund, Gjykata konstaton se kërkesa e parë KI237/23 e parashtruesit të kërkesës deklarohet si *“kërkesë e parakohshme”*, dhe rrjedhimisht ajo hedhet poshtë në pajtim me nenin 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
95. Gjykata e deklaroi kërkesën e dytë KI269/23 të parashtruesit si kërkesë të kategorisë (iii) *“të pambështetur ose të paarsyetuar”*, prandaj pretendimet për vendime të paarsyetuara gjyqësore janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

96. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata të vendosë masën e përkohshme dhe *“të pezullojë me veprim të menjëhershëm efektet juridike të Vendimeve të kontestuara (DPL. nr. 01/2023 të Komisionit Disiplinor dhe nr. 54/2023 të Ministrisë së Drejtësisë) deri në vendimin final të Gjykatës, [...] me qëllim të parandalimit të dëmeve dhe rreziqeve të pariparueshme për parashtruesin, dhe se masa e përkohshme është në interesin publik [...]”*.
97. Megjithatë, duke qenë se parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti dëshmitë e nevojshme për vendosjen e masës së përkohshme dhe duke u bazuar në faktin se Gjykata tashmë ka konstatuar se kërkesa KI237/23 e parashtruesit është e parakohshme dhe kërkesa KI269/23 është qartazi e pabazuar, e njëjta konstaton se kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet në pajtim me rregullat 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) dhe 45 (Vendimmarrja lidhur me kërkesën për masë të përkohshme) të Rregullores së punës (shih, rastin e Gjykatës [KI10/22](#), parashtrues *Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore*, Aktgjykim i 18 korrikut 2022, paragrafi 85).
98. Për këto arsye, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 27 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 34 (1) (b), 34 2 (2) dhe 44 dhe 45 të Rregullores së punës, më 28 maj 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani